

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6748
E enjte, 3 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Ushtarët e FSK-së mësojnë gjuhën gjermane | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORI AMERIKAN I KËRKON KURTIT TA SHTYJË AFATIN PËR TARGAT | FAQE 4-5



Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka theksuar të mërkurën sërish kërkesën e Shteteve të Bashkuara që Qeveria e Kosovës ta shtyjë afatin e zbatimit të vendimit për konvertimin e targave të makinave, ndërsa ka dënuar dëmtimin e pronave të

qytetarëve serbë në veri që kanë konvertuar targat e tyre. Insistimin e ShBA-së për shtyrje të plotë të afatit të reregjistrimit të targave e ka komentuar zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, i cili ka thënë se nuk ka arsye që ky vendim të ndryshojë

OPINION

OFENSIVA E RE DIPLOMATIKE: ME KOSOVËN KUNDËR PUTINIT? F. 6

Milazim
KRASNIQI



AKTUALE



DËSHTOJNË NEGOCIATAT, PD-ja SHKON E NDARË NË ZGJEDHJET LOKALE NË SHQIPËRI F. 5

FINLANDA DHE SUEEDIA PRESIN QË HUNGARIA TË RATIFIKOJË HYRJEN E TYRE NË NATO F. 2

EKONOMI



QEVERISË I KËRROHET TË NDAJË 200 EURO PËR PUNËTORËT E SEKTORIT PRIVAT F. 8

BAJRAMI: BUXHETI PËR VITIN 2023 NUK PARASHEH ZBATIMIN E LIGJIT TË PAGAVE F. 8

SPORT



MBI 30 MIJË EURO PËR SPORTISTËT E XHUDOS F. 10



HARADINAJ: AAK-ja NUK QËNDRON DUARKRYQ KUR JANË NË PYETJE INTERESAT NACIONALE | FAQE 3



BANKA BOTËRORE: TËRHEQJA E MJETEVE NGA TRUSTI DO TA NXISTE MË TEJ INFLACIONIN | FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Finlanda dhe Suedia presin që Hungaria ta ratifikojë hyrjen e tyre në NATO



HELSINKI, 2 NËNTOR - Presidenti i Finlandës, Sauli Niinisto, tha se llogarit në Hungarinë që ta ratifikojë aplikimin e shtetit të tij për anëtarësim në NATO. Ai i bëri këto komente më 2 nëntor pasi zhvilloi një bisedë telefonike me kryeministrin hungarez Viktor Orban. “Është gjë e mirë që Finlanda mund të llogarisë në Hungarinë sa i përket ratifikimit për anëtarësim në NATO. Mirëpres forcimin e mëtejshëm feno-urgjik,

por edhe si aleatë”, shkroi Niinisto në “Twitter” duke iu referuar historisë së përbashkët gjuhësore të dy shteteve. Po ashtu, ministri i Jashtëm suedez, Tobias Billstrom, shprehu optimizëm se Hungaria do ta ratifikojë edhe aplikimin e Suedisë në NATO. Ai kishte zhvilluar një bisedë telefonike me homologun e tij hungarez Peter Szijjarto disa ditë më parë. “Ne, po ashtu, kemi marrë mesazhe pozitive

gjatë bisedës sonë”, tha Billstrom në një konferencë për medie në Helsinki. Finlanda dhe Suedia kanë kërkuar që t’i bashkohen aleancës ushtarake të NATO-s në maj, në përgjigje të pushtimit rus të Ukrainës, por kërkesa e tyre hasi në kundërshtime nga Turqia. Hungaria dhe Turqia janë dy shtetet e vetme që ende nuk kanë ratifikuar aplikimet e Stokholmit dhe Helsinkit

Sondazhet: Netanyahu në rrugë drejt fitores në Izrael

JERUSALEM, 2 NËNTOR - Sipas sondazheve, ish-kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu është në rrugë të drejtë fitores së zgjedhjeve parlamentare që janë mbajtur më 1 nëntor në Izrael. Rezultatet e sondazheve kanë treguar se blloku i tij i krahut të djathtë ka fituar një shumicë të thjeshtë në parlament në krahasim me rivalët e tij. Një rezultat i tillë do të përbente kthim dramatik të Netanyahu, i cili është rrëzuar vitin e kaluar nga pushteti, pas 12 vjetëve të udhëheqësisë. “Jemi afër fitores së madhe”, u ka thënë ai mbështetësve në Jerusalem. Zgjedhjet e kësaj here janë konsideruar si votime për apo kundër kthimit të Netanyahu.

Rezultatet zyrtare, që mund të prodhojnë rezultat tjetër, pritet të bëhen publike në orët në vijim. Rivali i tij kryesor, kryeministri aktual Yair Lapid, ka thënë se “asgjë” nuk është e vendosur ende. Netanyahu, 73-vjeçar, është një prej figurave politike më kontroverze në Izrael, i cili kritikohet nga politikanët e qendrës, mirëpo ka një bazë të madhe të mbështetësve besnikë në partinë e tij Likud. Ai është përkrahës i madh i projektit të ndërtimit të vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor të pushtuar në luftën e vitit 1967. Vendbanimet në atë pjesë konsideron ilegale, sipas ligjit

ndërkombëtar, ndonëse Izraeli nuk e pranon këtë qëndrim. Netanyahu kundërshton krijimin e një shteti palestinez në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, si zgjidhje për konfliktin izraelito-palestinez, formulë e mbështetur nga komuniteti ndërkombëtar, përfshirë administratën e presidentit amerikan Joe Biden. Aktualisht Netanyahu është duke u gjykuar nën akuzat për rryshfet e mashtrime të cilat vetë ai i hedh poshtë. Partnerët e tij të mundshëm në koalicionin qeverisës kanë thënë se do ta reformojnë sistemin e drejtësisë, hap që do të mund t’u jepte fund procedurave gjyqësore kundër tij.



Kina izolon mbi 600 000 njerëz rreth fabrikës që prodhon iPhone



ZHENGZHOU, 2 NËNTOR - Kina ka izoluar një zonë me 600 000 banorë në qytetin Zhengzhou ku gjendet fabrika më e madhe në botë për prodhimin e telefonave iPhone, të kompanisë amerikane Apple, për shkak të shpërthimit të koronavirusit. Për koronavirusin e ri, që shkakton sëmundjen Covid-19, është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës. Të gjithë njerëzit, përveç punëtorëve të domosdoshëm dhe vullnetarëve për parandalim të koronavirusit, “nuk duhet të

largohen nga shtëpitë e tyre”, kanë thënë autoritetet në Zhengzhou. Ky vendim vjen pas disa pamjeve që kanë dalë në rrjetet sociale kineze javën e kaluar, në të cilat janë parë njerëzit duke u larguar nga fabrika që drejtohet prej gjigantit tajvanez “Foxconn” dhe prodhon produkte për Apple. Disa punëtorë janë ankuar për kushte të rënda, mungesë furnizimesh dhe se u është dashur të ikin nga fabrika në këmbë për t’i shmangur kufizimet që ekzistojnë në transport publik.

“Foxconn” punëson qindra mijëra punëtorë në Zhengzhou. Kina është ndër vendet e fundit në botë që zbaton strategjinë e zero rasteve me koronavirus. Autoritetet kineze vazhdojnë të vendosin masa izolimi dhe të kryejnë testime masive me qëllim të shmangies së shpërthimeve masive të virusit. Mirëpo variantet e reja kanë testuar aftësitë e zyrtarëve lokalë për ta parandaluar koronavirusin para se të përhapet, prandaj një pjesë e mirë e popullsisë në Kinë është duke jetuar vazhdimisht nën kufizime.

Kryeministrja daneze jep dorëheqje, por shpreson në formim të qeverisë së qendrës

KOPENHAGË, 2 NËNTOR - Partitë e qendrës së majtë kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e përgjithshme të Danimarkës. Ky proces është parë si votë besimi ndaj kryeministres Mette Frederiksen.

Blloku i saj ka fituar 90 ulëset e nevojshme për ta formuar qeverinë, mirëpo synimi i saj ka qenë për formimin e një koalicioni të gjerë qeveritar, andaj e ka dorëzuar dorëheqjen te mbretëresha. Frederiksen është detyruar të

shpallë zgjedhje të parakohshme në fillim të muajit tetor. Pakënaqësitë janë rritur pas një raporti, në të cilin qeveria është kritikuar si i ka menaxhuar disa kafshë në fermë në kohën e pandemisë së koronavirusit.



Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ushtarët e FSK-së mësojnë gjuhën gjermane

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, të mërkurën ka ndarë certifikata për dhjetë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) që kanë përfunduar me sukses kursin e gjuhës gjermane. "Sot pata kënaqësinë që së bashku me ambasadorin Rohde, zyrtarë dhe ushtarakë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, si dhe familjarë të kursantëve, të marr pjesë në ceremoninë e ndarjes së certifikatave për dhjetë pjesëtarët e FSK-së që kanë përfunduar me sukses kursin e

gjuhës gjermane", ka shkruar Mehaj në "Facebook".

Me këtë rast ai ka theksuar se ka shprehur mirënjohje të lartë për qeverinë dhe Ambasadën e Gjermanisë "për mbështetjen e vazhdueshme për ngritjen e kuadrove profesionale të ushtarakëve të FSK-së, sikur edhe me avancimin e njohurive në gjuhën gjermane". "Nga ana e tij, ambasadori gjerman, Rohde, përgëzoi kursantët për suksesin e arritur, duke theksuar se komunikimi funksional është

jashtëzakonisht i rëndësishëm për pjesëmarrjen në misione jashtë vendit. Më tej, ambasadori Rohde tha se bashkëpunimi me shtetin gjerman vazhdon të jetë i ngushtë me vendin tonë, në nivele të shumta ndërshtetërore, sidomos në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë", ka shkruar Mehaj. Sipas tij, deri më tani me ndihmën e shtetit gjerman, me sukses kanë kryer kursin e gjuhës gjermane pesë gjenerata të pjesëtarëve të FSK-së.



Konjufca: Afrim Zhitia e Fahri Fazliu, shembull kuptimplotë i sakrificës për liri

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Në nderim të heronjve Afrim Zhitia e Fahri Fazliu, të mërkurën, në përvjetorin e 33-të të rënies së tyre, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka bërë homazhe dhe vendosur lule te varrezat e tyre në Velani të Prishtinës. Pas homazheve, kryetari Konjufca ka thënë se Afrimi e Fahriu ishin shembulli më kuptimplotë i sakrificës për liri, që frymëzuan edhe brezat e mëpastajmë. "Erdhëm për t'i nderuar heronjtë tanë, të cilët, këtu e 33 vjet më parë, dhanë shembullin më sublim se si jepet jeta për lirinë e atdheut.

Ata me pushkë në dorë i luftuan forcat e okupatorit dhe ranë heroikisht në krye të detyrës", ka theksuar Konjufca. Kreu i Kuvendit shtoi se Afrim Zhitia e Fahri Fazliu ishin të frymëzuar nga veprimtaria e Rexhep Malës e Nuhi Berishës, të cilët dhanë jetën në po të njëjtën mënyrë. "Shembullin e tyre e ndoqën më pas mijëra djem e vajza të cilët në vitet 1998-1999 u bashkuan në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, duke e përjetësuar aktin heroik të Afrimit e të Fahriut. Do të kujtohen dhe nderohen sa të ketë popull shqiptar", ka thënë Konjufca.



Kuvendi maqedonas ndalon themelimin e shoqatave dhe të partive që nxisin urrejtje



SHKUP, 2 NËNTOR - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka miratuar disa ndryshime të reja në Ligjin për themelimin e shoqatave dhe fondacioneve, ndryshime që ndalojnë regjistrimin e tyre me emra të fashistëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, apo me emra të personaliteteve që nxisin mosdurim nacional, fetar, racor apo që fyejnë ndjenjat e ndonjë komuniteti të caktuar.

Ndryshimet ligjore janë miratuar me 67 vota të të gjitha partive politike në pushtet dhe opozitë. Ndryshimet u imponuan pas

regjistrimit të tri klubeve bullgare me emrat "Car Borisi i Tretë", "Vanço Mihajllor" dhe "Car Ferdinand", që kontestohen nga pala maqedonase për shkak se bartësit e emrave të këtyre klubeve ishin bashkëpunëtorë të Gjermanisë naziste dhe drejtues të luftërave për pushtimin e Maqedonisë së Veriut gjatë Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore.

Si kundërpërgjigje, një shoqatë maqedonase në Bullgari ka hapur një klub me emrin "Nikolla Vapcarov" që Sofja e quan si

provokim, pasi e konsideron si personalitet nga e kaluara historike bullgare.

Hapja e këtyre klubeve ka shkaktuar polemika të shumta jo vetëm mes shoqatave e historianëve, por edhe mes institucioneve shtetërore, të cilat i quajnë "provokime" hapjen e tyre. Hapja e klubeve më së shumti nxiti reagime nga komuniteti hebre, për faktin se pjesëtarët e këtij komuniteti ishin viktimë të veprimtarisë fashiste në Maqedoninë e Veriut gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Polica arreston dy vajza për ushtrim të dhunës ndaj një të moshuare

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar dy vajza të dyshuara për ushtrim të dhunës ndaj një të moshuare.

Policia ka njoftuar se ka identifikuar dy vajza të dyshuara, pasi në rrjetet sociale më 2 nëntor qarkulloi një video-incizim, ku shihej një punëtoreshë në një shtëpi të

pleqve në Pejë e cila ushtronte dhunë ndaj një gruaje të moshuar. "Të dyshuarat janë duke u intervistuar nga hetuesit e Stacionit Policor në Pejë", është thënë në njoftim.

Ndërkaq ministri i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Kosovës, Xhelal Sveçla, kërkoi që të përfshirët në këtë rast të

dalin para drejtësisë. "Veprimet e tilla të dhunës janë të papranueshme kudo që ndodhin, por në veçanti janë më të rënda kur ndodhin brenda institucioneve që konsiderohen të ofrojnë ndihmë dhe përkujdesje", ka shkruar ai në "Facebook". Sipas Sveçlës, hetimet për këtë rast po vazhdojnë.





Ambasadori amerikan i kërkon Kurtit ta shtyjë afatin për targat

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka theksuar të mërkurën sërish kërkesën e Shteteve të Bashkuara që Qeveria e Kosovës ta shtyjë afatin e zbatimit të vendimit për konvertimin e targave të makinave, ndërsa ka dënuar dëmtimin e pronave të qytetarëve serbë në veri që kanë konvertuar targat e tyre. Insistimin e ShBA-së për shtyrje të plotë të afatit të reregjistrimit të targave e ka komentuar zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, i cili ka thënë se nuk ka arsye që ky vendim të ndryshojë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, ka përsëritur të mërkurën kërkesën e Shteteve të Bashkuara që Qeveria e Kosovës ta shtyjë afatin e zbatimit të vendimit për konvertimin e targave të makinave, duke përmendur se Kosova ka të drejtë ta zbatojë këtë vendim. "Ne ritheksojmë kërkesën tonë për një zgjatje të plotë të periudhës së zbatimit në

mënyrë që tabelat RKS të mund të instalohen gjatë 12 muajve duke pohuar se Kosova ka të drejtë ta zbatojë këtë ndryshim", ka shkruar Hovenier në "Twitter".

Shtetet e Bashkuara kanë dënuar djegien apo shkatërrimin e pronave të atyre personave që kanë apo synojnë t'i reregjistrojnë makinat e tyre me targa ilegale serbe në RKS - Republika e Kosovës.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, i ka konsideruar aktet e tilla "frikacake dhe kriminale".

Policia e Kosovës ka njoftuar se në orët e hershme të së mërkurës ka pranuar informacione për vënien e zjarrit dhe djegien e një veture me targa RKS në Zubin-Potok, pronar i së cilës ka qenë një qytetar i komunitetit serb. "Policia e Kosovës më 2 nëntor në orën 03.34 (pas mesnatës) përmes linjës telefonike ka pranuar një informacion për djegien, vënien e zjarrit ndaj një veture të tipit 'Hyundai' me targa RKS, pronë e viktimës mashkull kosovar i komunitetit serb nga komuna e Zubin Potokut. Njësitë relevante policore nga Stacioni Policor Zubin-Potok i janë përgjigjur menjëherë vendit të ngjarjes, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme policore si dhe e kanë njoftuar ekipin e zjarrfikësve, i cili ka dalë në vendin e ngjarjes", ka njoftuar Policia e Kosovës, duke theksuar se mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të saj

ligjore, për hetimin dhe zbardhjen sa më parë të këtij rasti dhe të rasteve të tjera të zjarrvënieve, të ndodhura dhe të orientuara ndaj pronave private, kryesisht ndaj veturave të regjistruara me targa lokale RKS. "Ftojmë të gjithë qytetarët pa dallime të bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës, e cila do të kujdeset në vazhdimësi për ofrimin e sigurisë ndaj të gjithë qytetarëve pa dallime, për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, zbulimin e akteve të tilla kriminale dhe sjelljen para organeve të drejtësisë të kryerësve të këtyre veprave kriminale", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Ky njoftim vjen një ditë pasi Qeveria e Kosovës ka nisur ta zbatojë planin në tri faza për reregjistrimin e makinave me targat ilegale serbe në RKS. Faza e parë përfshin qortimin e shoferëve, e dyta parasheh gjobë deri në 150 euro për ata shoferë, e treta targa provuese. Lista Serbe - partia më e madhe

e serbëve në Kosovë - ka paralajmëruar rezistencë të ashpër qysh në momentin kur do të shqiptohet gjoja e parë lidhur me targat.

Zbatimi i këtij plani pritet të përfundojë më 21 prill dhe, nga ajo datë, në qarkullim do të lejohen vetëm makina me targa RKS.

Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se do të dëshironte t'i shihte përfaqësuesit e serbëve në Kosovë të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në ulje të tensioneve. "Shembull, t'ua sqarojnë serbëve të Kosovës realitetin që në Kosovë duhet të kenë targa të licencuara nga Kosova", ka shkruar Rohde në "Twitter".

Autoritetet në Serbi kërkojnë targa neutrale ndaj statusit të Kosovës.

Insistimin e Shteteve të Bashkuara për shtyrje të plotë të afatit të reregjistrimit të targave e ka komentuar zëvendëskryeministri Besnik

Boltoni: Nuk shoh ndonjë marrëveshje të shpejtë në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Diplomati amerikan, njëherësh ish-këshilltar për Siguri Kombëtare i ish-presidentit amerikan Donald Trump, John Bolton, thotë se nuk sheh ndonjë marrëveshje të shpejtë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ai thotë se mundësia për një marrëveshje mund të kishte ekzistuar tre apo katër vjet më parë.

Boltoni, në një intervistë për gazetën serbe "Politika", ka thënë se nuk mund të ketë stabilitet nëse palët [Kosova dhe Serbia] nuk janë të gatshme të arrijnë marrëveshje. "Për momentin nuk shoh ndonjë zgjidhje në horizont siç ishte më parë. Kur isha këshilltar për Sigurinë Kombëtare në administratën e presidentit Trump kisha njëfarë përfshirje në adresimin e kësaj çështjeje [dialogu Kosovë - Serbi]. Kishte njerëz që u përpoqën të bënin atë mund të bëhej për të arritur një marrëveshje", tha Boltoni.

Ai tha se "nëse Serbia dhe Kosova mund të pajtohen, me gjithë vështirësitë e brendshme, dhe të arsyetojnë një marrëveshje të tillë, mendoj se në atë rast nuk duhet të ndërhyjnë faktorët e jashtëm dhe të thonë se zgjidhja nuk është e pranueshme për ta, sepse mund të ketë pasoja diku tjetër". "Mundësia për të arritur një marrëveshje mund të kishte ekzistuar tre apo katër vjet më parë. Tani një opsion i tillë është i pamundur. Megjithatë le të marrim si shembull mosmarrëveshjet e kahershme të pikëpamjeve në lidhje me emrin Maqedonia e Veriut, të cilat u zgjidhën me kalimin e kohës. Nëse negociatat do t'u lihen palëve të angazhuara, do të jepte rezultate, në të kundërt pengohet hyrja e atyre vendeve në Bashkimin Evropian dhe NATO. Për mbrojtjen e qytetarët të tyre dhe krijimin e kushteve më të mira ekonomike duhet të punohet për sigurinë reciproke rajonale dhe avancimin e ekonomisë", ka thënë Boltoni.



Dështojnë negociatat, PD-ja shkon e ndarë në zgjedhjet lokale në Shqipëri

TIRANË, 2 NËNTOR - Në Shqipëri kanë dështuar negociatat mes dy grupimeve brenda Partisë Demokratike (PD), që kjo parti më e madhe opozitare në vend të shkojë me kandidatë të vetëm në zgjedhjet vendore të 14 majit të vitit 2023. Takimi i zhvilluar një ditë më parë dështoi dhe secila palë akuzoi njëra-tjetrën për mungesë vullneti.

Grupi parlamentar i PD-së, që njih si drejtues të partisë Enkelejd Alibeajn, në një deklaratë për mediet shprehu keqardhje për përfundimin pa sukses të bisedimeve dhe akuzoi palën tjetër se vuri në plan të parë interesa të ngushta. "Në këtë situatë të mërkurën do të mblihdet kryesia e partisë për t'i hapur rrugë krijimit të gjitha kushteve për përgatitjet dhe pjesëmarrjen e PD-së në zgjedhjet e ardhshme vendore", thuhet në deklaratë.

Ndërkaq kreu i PD-së, Sali Berisha, u tha gazetarëve se grupi që mbështet Alibeajn nuk do zgjidhje. Siç tha ai, ky grup, nëse dëshiron, mund ta krijojë



fraksionin e vet. "Por ata nuk duan as statutin, as primaret dhe as fraksionin. Ai që prek flamurin e PD-së i ka bërë shumë keq

hesapet. Këtë do ta shikoni në ditët në vijim", deklaroi Berisha. Më herët të dyja palët deklaruan se do të negocionin për ta gjetur

kompromisin në mënyrë që të mos përsëritej ajo që ndodhi më 6 mars të këtij viti, kur u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme lokale.

Në këto zgjedhje PD-ja doli me dy kandidatë, njëri nga mbështetësit e Sali Berishës dhe tjetri nga mbështetësit e Lulzim Bashës. Në garën për gjashtë bashki, PD-ja humbi pesë prej tyre dhe mori vetëm Shkodrën.

Berisha arriti t'i regjistronte kandidatët e tij nën siglën e Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI), në atë kohë e drejtuar nga Monika Kryemadhi (bashkëshortja e ish-presidentit Ilir Meta).

Pak ditë më parë Sali Berisha firmosi marrëveshje bashkëpunimi për zgjedhjet lokale me Partinë e Lirisë, të drejtuar nga ish-presidenti Ilir Meta.

Dy grupet brenda PD-së janë në një betejë ligjore, pasi gjykata e shkallës së parë njohu statutin e miratuar nga Kuvendi i thirrur nga Sali Berisha në muajin dhjetor të vitit të kaluar. Pak muaj më vonë, pas dorëheqjes së Lulzim Bashës, kontrollin e PD-së e mori Sali Berisha. Përplasja ka përfunduar në Gjykatën e Apelit, e cila më 3 nëntor do ta nisë shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Bislimi. Ai ka theksuar se nuk ka arsye që ky vendim të ndryshojë. "Nuk besoj se ka arsye që ky vendim të ndryshojë. ShBA-ja, si vend mik, ka dhënë sugjerimet e veta për Republikën e Kosovës me idenë që kjo do të ndihmonte futjen në legalitet të të gjithë poseduesve të veturave me targa ilegale. Ajo që medieve si duket po u ik, është pikënisja e interesimit të ShBA-së. Askush

nuk e konteston legjitimitetin e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe askush nuk e konteston faktin që këto targa janë ilegale. Askush nuk e konteston faktin që këto targa nuk është dashur të ekzistojnë fare - maksimumi pas janarit të vitit 2018. Do të thotë, ekzistenca e tyre tregon se Serbia i ka shkelur marrëveshjet ndërkombëtare", ka thënë Bislimi për "Radion

Evropa e Lirë". Përmes një konference për medie edhe zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price, ka theksuar se Shtetet e Bashkuara dhe komuniteti ndërkombëtar i kërkoi Kosovës shtyrjen dhjetëmuajshe të vendimit për konvertimin e targave të pjesshme. "Ne kemi qenë të qartë, publikisht dhe privatisht,

se komuniteti ndërkombëtar, përfshirë Shtetet e Bashkuara, kërkon një shtyrje të plotë të zbatimit të këtyre çështjeve. Ne nuk kërkojmë një shtyrje të pjesshme, nuk kërkojmë zbatim në fazë. Komuniteti ndërkombëtar i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës një shtyrje të plotë", ka thënë ai, duke theksuar se po vazhdojnë diskutimet me palët në rajon dhe më Bashkimin Evropian.

Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Procesi i negociatave pritet të përfundojë me marrëveshje ligjrisht të detyrueshme. Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranon, duke insistuar në "zgjidhje kompromisi".

Ofensiva e re diplomatike: Me Kosovën kundër Putinit?

Çfarë marrëveshjeje po ofrojnë Franca e Gjermania, që po përkrahen edhe nga ShBA-ja? Po ofrojnë një marrëveshje pa njohjen e Kosovës si shtet nga ana e Serbisë! Pra, po tentojnë të bëjnë një marrëveshje, e cila do ta linte Putinin pa argumentin e Kosovës.



Milazim KRASNIQI

Ofensiva e kohëve të fundit e diplomacisë amerikane dhe evropiane për të gjetur një zgjidhje për konfliktin ndërmjet Kosovës e Serbisë ka ngjashmëri me përpjekjet për ta fikur një zjarr me mjete rrethanore, meqë mjetet efikase për fikjen e zjarrit vlerësohet se nuk ia vlen të përdoren. Në situata të tilla zgjidhja që kërkohet nuk është e plotë dhe e dyta, më shumë bëhet përpjekje të dëmtohet ndonjë objekt tjetër sesa të shpëtohet i tërë konstruksioni që trajtohet. Po përiqem ta dekonstruoj këtë situatë.

Ndërrhyrja e Serbisë në Kosovë pas vitit 2008 - e lejuar, por e dozuar

Administrata amerikane dhe politikantë okazionalë evropianë, që nga vitit 2008, kur e kanë njohur Kosovën si shtet, (pa pesë shtete të BE-së) e kanë lejuar Serbinë që të fusë hundët në punët e Kosovës, megjithëse në mënyrë të dozuar. Dozat e ndërhyrjes janë lejuar të jenë të ndryshme, herë më të forta e herë më të dobëta, varësisht nga qëllimet që kanë pasur në raport me regjimin e Beogradit. Kështu, si dozë më e lartë e shkarkimit çartist-nazist serb ka qenë djegia e pikave doganore në shkurt 2008, si reagim ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ndaj atij vandalizmi në kufi dhe ndaj barbarizmit që shoqëroi protestat në Beograd, me ç'rast u sulmua edhe ambasada amerikane, nuk pati reagime të vendosura. E pra, ishte rasti ideal që Serbisë t'i tregohet vija e kuqe përtej së cilës nuk do të duhej të guxonte të shkilte, pas proklamimit të pavarësisë nga ana e Kosovës dhe pranimit të asaj pavarësie nga ShBA-ja, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia. Kjo vijë e kuqe e frenimit të Serbisë do të duhej të vihej edhe për një arsye morale: me Procesin e Vjenës Serbisë i ishin bërë shumë koncesione, me shpresë se ajo do ta pranonte Planin e Ahtisarit dhe në atë mënyrë do të mbyllej konflikti me anëtarësimin e Kosovës në OKB. Ndonëse Serbia i shfrytëzoi të gjitha ato koncesione që iu bënë,

ajo Planin e Ahtisarit e refuzoi. Përveç që e refuzoi, Serbia përdori agresion të hapur kundër Kosovës në pikat doganore. Prandaj, ishte rasti të suspendoheshin koncesionet që i ishin bërë Serbisë e serbëve lokalë (statusi i veçantë i objekteve fetare dhe i Kishës Ortodokse Serbe, formimi i komunave serbe, vendet e rezervuara në Kuvend e në qeveri, etj.) deri sa të pranoheshin realitetin e ri. Në vend të një qëndrimi të vendosur kundër atij sabotimi e atij agresioni, ShBA e BE filluan ta miklonin Serbinë edhe më shumë, duke i lejuar ndërhyrje të vazhdueshme në punët e Kosovës, madje duke lejuar edhe mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare e presidenciale të Serbisë në Kosovë, gjë që e ushqeu pretendimin irredentist të serbëve të Kosovës. As sot, kur dihet se ishte politikë krejtësisht e gabueshme, nuk është e qartë pse lejoheshin ato ndërhyrje të Serbisë në Kosovë: a lejoheshin për ta zbutë disi Serbinë, apo lejoheshin për ta ngulfatë Kosovën e pavarur. Rezultati flet më shumë në favor të tezës së dytë, pra për ta ngulfatë Kosovën. Po pse? Meqë pesë shtete të Bashkimit Evropian nuk e njohën Kosovën si shtet, Bashkimi Evropian tërë kohën bëri lojëra balancuese, që të kënaqte edhe ato pesë shtetet mosnjohëse, duke dëmtuar rëndë stabilitetin dhe zhvillimin e Kosovës. Në këtë kontekst, mbajtja e regjimit të vizave është pjesë e asaj strategjie ngulfatëse të Bashkimit Evropian kundër Kosovës si shtet. Bile pas marrjes së mandatit nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së për ta ndërmjetësuar dialogun, Bashkimi Evropian fitoi mandat që atë ngulfatje të shtetit të Kosovës ta bënte në mënyrë të programuar: mandatin e përdori që t'i ofronte sa më shumë favore Serbisë, gjoja për ta joshur në rrugën e saj të integritimit evropian dhe të shkëputjes nga përfaqimi rus. Kjo qasje serbofile bëhet e qartë edhe nga moszbatimi i marrëveshjeve të ndryshme të arritura në Bruksel. Kjo stërzgjatje e procesit ka qenë pjesë e strategjisë së Brukselit, për shkak të problemeve të vetë Bashkimit Evropian, për hatër të shteteve që nuk e njohin Kosovën si shtet, Spanjes, Rumanisë, Sllovakisë, Greqisë e Qipros. Në këtë mes, sapo të thuhet se Qiproja (pjesa greke) është shtet i Bashkimit Evropian, e ke edhe më të qartë lojën hipokrite të Bashkimit Evropian me Kosovën: Qiproja e ndarë dhe që është territor jashtë Evropës, është

anëtare e BE-së, ndërsa Kosova, që është në zemër të Evropës, nuk pranohet si shtet, edhe pse Kosova ka dalë në mënyrë legale nga procesi i shpërbërjes së ish federatës së Jugosllavisë, ku ka qenë pjesë përbërës e federalizmit jugosllav. Bashkimit Evropian nuk ia ka mbushur mendjen as rekomandimi i Gjykatës së Drejtësisë që ka konfirmuar se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Përkundrazi, Bashkimi Evropian lejon që një gjysmështet jashtevropian si Qiproja, të vendos për Kosovën, pra, për një shtet mirëfilli evropian, i cili ka ndjekur rrugën legale të shtetndërtimit dhe është proklamuar shtet me një akord ndërkombëtar. Kjo është ajo që kemi parë deri tash në lojërat hipokrite veçmas të Bashkimit Evropian në drejtim të Kosovës. Nëse kjo ka qenë strategjia e BE-së nga vitit 2008 e deri tash, çka ka ndryshuar që e ka nxitë këtë ofensivën e re diplomatike, të mishëruar në Llaqjakun, Borellin dhe Eskobarin? Mos e kanë kuptuar gabimin që kanë bërë qëllimisht?

Motivet e Perëndimit dhe muralet e Putinit

Dy mund të jenë motivet e ofensivës së re diplomatike të Brukselit e të Uashingtonit për të kërkuar një zgjidhje, nga sa po shihet krejt gjysmake, për konfliktin ndërmjet Kosovës e Serbisë. Motivi i parë mund të burojë nga frika që ka shkaktuar në Perëndim agresioni rus kundër Ukrainës. Rusia mund ta përdorë Serbinë, e cila është pothuajse vasale e Ruisë, për të shkaktuar një konflikt të armatosur në Ballkan, në mënyrë që të krijohej njëfarë paralelizmi me atë që po bën Rusia në Ukrainë. Një konflikt në Kosovë, në zonën për të cilën përkujdeset NATO-ja, do ta detyronte Perëndimin që të koncentrohej në menaxhimin e asaj krize, e cila shumë lehtë mund të përhapej në shtete anëtare të NATO-s, konkretisht në Maqedoninë e Veriut e në Shqipëri, ashtu siç në fakt u përhapë në formën e katastrofës humanitare në vitin 1999. Tash do të mund të përhapej edhe në formë më të rrezikshme, falë kapaciteteve luftarake, që tashmë posedon edhe Kosova si shtet. Nga ana tjetër, opinionin publik në Serbi me mbi 70 për qind e përkrahë agresionin rus kundër Ukrainës, gjë që do ta lehtësonte një përfshirje të Serbisë në një konflikt, me idenë se po e ndihmon Rusinë dhe Putinin. Muralet e Putinit janë të përhapura gjithandej vendbanimeve nëpër Serbi, duke qenë ekspozita më gjigante në tokën serbe. Ndërsa vetë presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiqi nga ana e tij, në një rast ka

deklaruar se ai kurrë nuk e merr ndonjë vendim pa u konsultuar me Putinin. Pra, kur është gjendja kështu, nëse Putini ia kërkon një veprim agresiv, Vuçiqi është i obliguar të veprojë. Bile jo vetëm nga bindja e tij ose e opinionit publik po edhe nga rreziku për jetë e tij, ngase shërbimet sekrete ruse bëjnë ligjin në Serbi. Vetë ministri aktual i brendshëm është eksponent i Putinit. Pra, Bashkimi Evropian dhe Uashingtoni si duket janë alarmuar nga ky lloj gangrenizimi i ndikimit rus në Serbi dhe si rrjedhojë po përiqen ta frenojnë ndikimin rus, duke e mbyll konfliktin Kosovë Serbi me një marrëveshje, për t'ia hequr Putinin nga dora kartën e manipulimit me rastin e Kosovës. Por sa është reale kjo? Meqë ShBA dhe BE janë vonuar shumë për ta mbyll këtë krizë dhe nga ana tjetër e kanë ndihmuar vetë fuqizimin e Ruisë, tash situata është absurde: Rusia e përdorë këtë rast ashtu si i leverdisë. Në një version, sigurisht për t'i bërë Serbisë presion, që të mbetet vasale ndaj Ruisë, shtetarët e Ruisë pohojnë se precedentin e Kosovës duhet të vlejë edhe për rajonet e shkëputura në Gjeorgji (Abhazinë dhe Osetinë e Jugut) si edhe rajonet e pushtuara në Ukrainë pas agresionit të 24 shkurtit 2022. Gjasat janë se pikërisht kjo qasje ruse e ka alarmuar Uashingtonin dhe Brukselin dhe i ka shtyrë të kërkojnë me ngut një marrëveshje ndërmjet Kosovës e Serbisë, për t'ia hequr këtë kartë nga dora Ruisë.

Çfarë marrëveshjeje po ofrojnë Franca e Gjermania, që po përkrahen edhe nga ShBA? Po ofrojnë një marrëveshje pa njohjen e Kosovës si shtet nga ana e Serbisë! Pra, po tentojnë të bëjnë një marrëveshje, e cila do ta linte Putinin pa argumentin e Kosovës. Pra, në stilin që meqë nuk ka njohje nga Serbia për Kosovën, nuk mund të merret njohje as për rajonet e pushtuara nga Rusia. Nga aspekti moral mbetet një njollë e zezë e këtyre shteteve, që vetë e kanë ndihmuar në mënyrë përpjekjet e saj për t'u bërë shtet, ndërsa tash i ofrojnë një projekt që e përjashton pavarësinë, në raport me Serbinë. Ndërsa për implikimet e mundshme, të tërheqjes së njohjeve nga shtetet të tjera, në një rast të një marrëveshjeje pa njohje, tash për tash askush nuk mund të dijë. Motivi tjetër mund të jetë stabilizimi i Ballkanit për shkak të rrugëve të reja që planifikohen për transportimin e gazit nga Azerbajxhani dhe hapësirat e tjera joruse. Tashmë është e qartë se rëndësia gjeoekonomike dhe gjeopolitike e Ballkanit është shumë më e madhe se sa e kanë vlerësuar në kohë rehatie byrokratët e Brukselit. Në këtë aspekt, edhe rrugët e refugjatëve nga Azia janë më poroze në një

Ballkan jostabil dhe veçmas me një Serbi proruse, e cila në mënyrë perfide e ka bërë lojën me emigrantët gati si Bellorusia.

Kosova si shtet pa substancë, për ta mbikëqyrë më lehtë, apo për ta riserbizuar?!

Pra, përfundimi im është se ngutia e tashme për të arritur ndonjë marrëveshje gjysmake ndërmjet Kosovës e Serbisë, pas një injorimi të giatë të problemit, është imponuar nga zhvillimet dhe nga pasojat e agresionit ushtarak rus në Ukrainë. Thjesht, nuk ka të bëjë me pranimin e realitetit se Kosova ekziston si shtet i pavarur dhe që kjo t'i imponohet Serbisë si fakt në termat e një marrëveshjeje obligative. Jo. Në fakt, po synohet të arrihet një marrëveshje gjysmake, por e cila amortizon pretendimin rus që ta shfrytëzojë precedentin e Kosovës për rajonet e pushtuara gjeorgjiane, ukrainase e moldave. Dhe po synohet që me këtë marrëveshje, t'i bëhet presion Serbisë që të shkëputet nga influenca ruse. Në këtë prizëm rreziku për Kosovën është real: linja e tashme e diplomacisë perëndimore pot ë të kuptohet se sa më shumë që Serbia të shkëputet nga influenca ruse, aq më shumë do të kompensohet duke i dhënë favore në Kosovë. Tashmë është bërë publike se flitet për një marrëveshje pa njohjen e Kosovës si shtet, pastaj për një bashkësi të komunave serbe me kompetenca të mëdha, për një status të Kishës Ortodokse Serbe të njëjtë me atë që ka në Serbi. Nuk është gabim nëse thuhet se plani i bazuar në modelin e dy Gjermanive, synon një Kosovë të riserbizuar.

Prandaj pashmangshëm shtrihet pyetja: çka mbetet nga substanca e shtetit për Kosovën? A mund të jetë përgjigje se mund të mbetet modeli i federatës boshnjake?! Nëse varet nga paragjykimet e rrënjosura islamofobike në disa qarqe evropiane, ku Franca është kampione, përgjigja mund të jetë e saktë. Nuk është fshehtësi që ato qarqe miterano-peniane duan të ketë një mbikëqyrje të ashpër mbi shqiptarët e Kosovës, si mbi boshnjakët e Bosnjës. Qoftë dhe duke toleruar arrogancën rusofile e antievropiane të tipave si Dodiku e Vulinin. Tash për tash kjo është traseja ku po kërkohet të imponohet një marrëveshje gjysmake ndërmjet Kosovës e Serbisë, gjë që do të thotë se as kërcënimi rus nuk e ka ndryshuar qasjen islamofobike ndaj Kosovës.

Se sa e kuptojnë dhe si do t'i kundërvihen kësaj politike udhëheqësit e Kosovës, mbetet të shihet. Por nga sa po shihet, ata nuk ia kanë idenë se ku po synon ta ngatërrojë plani franko-gjerman Kosovën: te qërimi i hesapeve me kauzat e Putinit.

Çeku pret në takim anëtarët e Këshillit të ri Drejtues të Baletit

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka pritur në takim anëtarët e Këshillit të ri Drejtues të Baletit, në përbërje nga Fisnik Smani, Lejla Pula, Jeta Musolli, Sihana Vitaku dhe Pajtim Zogaj. Bashkë kanë diskutuar për

sfidat që ka aktualisht ky institucion dhe prioritetet e planet për dinamizimin e punës. Duke iu uruar suksese anëtarëve të rinj në përgjegjësinë që kanë marrë, ministri Çeku ka theksuar se përkrahja e MKRS-së për ta zhvilluar baletin nuk do të

mungojë asnjëherë, ndërsa anëtarët e Këshillit e falënderuan ministrin për pritjen dhe besimin për t'i dhënë një drejtim të ri Baletit, duke theksuar se në këtë institucion kanë parë entuziazëm të madh të punës.



Hoti thotë se po ndodh dështim total në menaxhimin e buxhetit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka theksuar se është duke ndodhur dështim total në menaxhimin e buxhetit në kohën e krizës më të madhe ekonomike që kemi parë në dekada. Hoti ka theksuar se, sipas raportit të buxhetit për janar-shtator 2022, vetëm 21 për qind e investimeve kapitale janë realizuar (158 milionë nga 764 milionë të planifikuara). “Kjo është 29 për qind më pak se më 2021 dhe 24 për qind më pak se më 2020. Kjo po na kushton shtrenjtë. Për shkak të mosrealizimit të shpenzimeve kapitale, sot ekonomisë i mungojnë rreth 200 milionë euro në qarkullim. Ka ministri, siç është Ministria e Industrisë, me vetëm 5 për qind realizim të shpenzimeve kapitale, apo Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave me 6 për qind, Ministria e Ekonomisë me

13 për qind, Ministria e Mbrojtjes me 15 për qind etj”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Ai ka theksuar se paratë e gatshme në llogarinë e qeverisë kanë arritur në 678 milionë euro, dyfish më shumë sesa që është e nevojshme. “Rrjedhimisht mund të ishte pezulluar akciza në naftë si dhe përgjysmuar TVSh-ja në naftë dhe në mallra ushqimore pa shkaktuar asnjë vështirësi buxhetore për qeverinë. Sikur të mos mblidheshin këto mjete vetëm sa për t'i mbajtur në llogari, sot ekonomia do të kishte edhe 300 milionë euro në qarkullim. Këto mjete tanimë janë zhvlerësuar nga infalioni për rreth 20 për qind, që është rreth 136 milionë euro”, ka shkruar Hoti, duke shtuar se këta as nuk i shpenzojnë mjetet e mbledhura për projekte, as nuk ua lënë qytetarëve. “Pasoja po i bartim të gjithë. Sot në ekonomi ka rreth 500 milionë euro më pak për shkak të paditurisë”, ka shkruar Hoti.



Haradinaj: AAK-ja nuk qëndron duarkryq kur janë në pyetje interesat nacionale



FUSHË-KOSOVË, 2 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vazhduar bashkëbisedimin me qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës, ku tha se ka qenë dhe do të jetë gjithmonë i gatshëm ta ndihmojë vendin. “Në Fushë-Kosovë, ku bashkohen qytetarët e mbarë Kosovës dhe Luginës, sqarova se i kam vënë vetes obligim që t'i vizitoj të gjitha komunat e vendit për bashkëbisedim me qytetarët, obligim ky që del nga fakti se kam qenë pjesë e çlirimit dhe shtetndërtimit të vendit, pjesë e politikës dhe institucioneve”, ka shkruar Haradinaj në

“Facebook”.

Haradinaj ka thënë se marrëveshja obliguese ligjore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me njohje reciproke, ishte fokus i këtij takimi, pasi që vendimet e saj prekin të ardhmen e secilit prej nesh dhe fëmijëve tanë. “Sa i përket qeverisjes në vend, shpreha shqetësimin tim se vendi po shkon prapa, krizat ekonomike dhe energjetike vetëm po thellohen. Përkundër zhgënjimit që kemi për këtë lloj qeverisje, unë dhe Aleanca jemi të gatshëm ta ndihmojmë Kosovën dhe asnjëherë nuk do të qëndrojmë duarkryq kur janë në pyetje interesat nacionale”, ka shkruar Haradinaj.

Ndërtimi i trotuarit, zgjidhet kontesti mes komunës dhe Stacionit të Policisë në Deçan

DEÇAN, 2 NËNTOR - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka njoftuar se është zgjidhur tashmë kontesti për

ndërtimin e trotuarit të Stacionit të Policisë. “Më në fund një punë e mirë për Deçanin, që ka të bëjë me

ndërtimin e trotuarit të Stacionit të Policisë, kontest tashmë i zgjidhur pas një viti. Falënderoj të gjithë aktorët që

bënë të mundur implementimin e këtij projekti”, ka shkruar Ramosaj në “Facebook”.



Banka Botërore: Tërheqja e mjeteve nga Trusti do ta nxiste më tej inflacionin



PRISHTINË, 2 NËNTOR - Eksperti i Bankës Botërore, Richard Record, është shprehur kundër tërheqjes së mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës pasi, siç thotë, një veprim i tillë do ta rriste edhe më shumë inflacionin, që aktualisht është mbi 12 për qind. "Masa e propozuar për të lejuar një raund të dytë të tërheqjeve të konsiderueshme nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës do të ishte regresive, do ta rrezikonte qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit të pensioneve dhe do ta nxiste edhe më tej inflacionin", ka thënë Record, ekonomist kryesor i Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Tash e sa muaj kërkesë e

opozitës në Kosovë është t'u mundësohet qytetarëve të tërheqin deri në 30 për qind e mjeteve nga Fondi për ta përballuar, siç thuhet, më lehtë inflacionin në rritje. Qeveria e Kosovës deri më tash ka kundërshtuar, ndonëse në vitin 2020, ajo u ka mundësuar qytetarëve të tërheqin 10 % të kursimeve të tyre nga Trusti, për të përballuar, siç është thënë, vështirësitë financiare të shkaktuara nga pandemia Covid-19. "Masat në përgjigje ndaj inflacionit duhet të jenë të shënjestruara dhe me afat të kufizuar kohor", ka theksuar Record. Në intervistën dhënë REL-it, ai ka folur edhe për rëndësinë e reformimit të skemës sociale për mënyrat se si mund të rriten eksportet e Kosovës e të tjera.

Bajrami: Buxheti për vitin 2023 nuk parasheh zbatimin e Ligjit të Pagave

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se buxheti për vitin 2023 nuk parasheh zbatimin e Ligjit të Pagave dhe nuk parasheh as rritje pensionesh. "Kur Kosova po përballlet me inflacion, Qeveria e Kosovës ka propozuar 'buxhetin më të madh në histori', ku nuk përfshin rritje të pensioneve. Nuk ka paraparë as kosto për zbatimin e Ligjit të Pagave. Pra, nuk ka paraparë rritje pagash, nuk ka paraparë as indeksim të pensioneve dhe pagave për normën e inflacionit", ka shkruar Bajrami në "Facebook". Ajo ka theksuar se inflacioni është 12.7 për qind. "Për shportën bazë të konsumatorit rritja ka kaluar 50-përqindëshin. Më së shumti nga inflacioni po preken

familjet pa të ardhura dhe ato me të ardhura të ulëta", ka shkruar ajo.

Në gjithë këtë situatë, Bajrami ka thënë se qeveria s'ka asnjë plan. "Ndoshta, kjo qeveri ka plan të ikë sepse deri më tash s'po shohim as hapa minimalë për t'u përballuar me këtë situatë të rënduar. Partia në pushtet dhe komplet qeveria janë kurthuar në temën e targave. Kanë shndërruar dialogun me Serbinë në temë qendrore. Konfrontimin me ShBA-në dhe BE-në e kanë bërë përditshmëri. Dhe, s'kanë asnjë zgjidhje për ekonomi, s'kanë zgjidhje për arsim, s'kanë zgjidhje as për shëndetësi", ka shkruar deputetja e LDK-së, duke shtuar se "ndoshta partia në pushtet dhe komplet qeveria po punojnë në video propaganduese se si 'Kosova po bëhet si Kroacia?'".



Qeverisë i kërkohet të ndajë 200 euro për punëtorët e sektorit privat



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti që të merret në konsideratë gjendja e rënduar financiare e bizneseve dhe të mos kushtëzohen punëtorët e sektorit privat ashtu siç nuk janë kushtëzuar punëtorët e sektorit publik dhe kompanive publike. Po ashtu, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë ka

kërkuar nga Qeveria dhe Kuvendi që të merren parasysh këto kërkesa dhe të bëhet ekzekutimi i menjëhershëm apo në dy pjesë për punëtorët e sektorit privat në shumën 200 euro, ashtu siç është duke iu dhënë punëtorëve të sektorit publik, pasi këta punëtorë së bashku me bizneset janë më meritoret dhe shtylla e buxhetit dhe zhvillimit të vendit. Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, Skënder Krasniqi, në një

konferencë për medie, ka thënë se, sipas vendimit të qeverisë të muajit shtator, punëtorët e sektorit publik për katër muaj radhazi po marrin nga 50 euro më shumë ose 200 euro, pavarësisht se ata i kanë pagat më të larta se në sektorin privat. Krasniqi ka thënë se punëtorët e kompanive publike po marrin shtesa nga buxheti i shtetit pa asnjë kushtëzim edhe pse pagat e tyre janë pothuajse për 80 për qind më të larta se të sektorit privat.

Pse paraardhësi i Boris Johnsonit u grind me Ataturkun dhe pse ia thyen kokën me gurë?



Noel MALCOLM
Përktheu: Daut DAUTI

Njëqindvjetori vjen së shpejti: më 1 nëntor 1922, Asambleja e Madhe Kombëtare e Turqisë e shfuqizoi Zyrën e Sulltanit. Rreth 600 vjet të historisë perandorake otomane, morën fund. Sulltani i fundit, Mehmeti VI, u kontrabandua nga Stambolli nga garda britanike, duke përfunduar si mysafir i Musolinit në resortin e qytetit San Remo. Ai do të vdesë aty pas katër viteve, aq i varfër sa që autoritetet italiane ia konfiskuan arkivolin derisa nuk u pagua borxhi ndaj një tregtari lokal.

Tri ditë pas shfuqizimit të sulltanit, një gazetar dhe politikan prominent, Ali Kemal, qëndronte ulur në karrigen e berberit në një hotel të Stambollit, kur një grup i njerëzve e rrëmbyen dhe e futën në veturën që priste jashtë. Trupi i tij u gjet dy ditë më vonë; ishte rrahur, fytyra ishte e shtypur me gurë dhe pastaj ishte varur. Ai la në Angli djalin e tij 13 vjeç të quajtur Osman Wilfred, i cili do të rritej me mbiemrin Johnson – stërnipi i të cilit do të bëhet kryeministër i Britanisë së Madhe, deri me rënien e tij më pak të dhunshme më 2022.

Ali Kemal paraqitet shkurtimisht në librin e ri të rëndësishëm të Ryan Gingerasit, kurse arsyeja e paraqitjes nuk ka të bëjë asgjë me

stërnipin e tij (një lidhje e cila me vetëpërmbytje të ashpër të Gingerasit, nuk përmendet). Pikëpamja e gjerë e asaj se çfarë ka ndodhur në Turqi më 1922, është se rendi i vjetër pa efekt, i personifikuar me sulltanin dhe politikanët e oborrit të tij, të përkrahur nga reaksionarët, më në fund ishte nxjerrë anash pasi që modernizuesit dhe sekularët e udhëhequr nga Kemal Ataturku, kishin marrë pushtetin. Ky ka qenë momenti kur programi kolosal i Mustafa Kemal Ataturkut për reforma perëndimore, më në fund kishte filluar – duke e çuar Turqinë në shekullin XX.

Por, Ali Kemal është i rëndësishëm për shkak se ishte intelektual më liberal dhe më perëndimor që do të dëshironit – dëshmohej me martesën e tij me një angleze (nejëse, anglo-zvicerane), anglofilinë e thellë kulturore dhe politike, fjalimet e fuqishme denoncuese ndaj përgjegjësve për vrasjet masive të armenëve gjatë Luftës së Parë Botërore dhe sulmeve ndaj korrupsionit – të shkruara në një prozë gërryese të një gazetari të lindur. Megjithatë, ishte vlarë për shkak se e kundërshtoi Ataturkun dhe tërë lëvizjen nacionaliste që tashti po vinte në pushtet.

Për observuesin e rëndomtë, të ushqyer vetëm me pretendimet standarde të Turqisë moderne, kjo duket si kontradiktë e çuditshme. Por, kur i dilni në fund librit

të Gingerasit, e kuptoni pse dikush si Ali Kemal ka marrë atë pikëpamje, derisa po ashtu duket se kjo e vendosë atë (për ta përdorur këtë frazë të diskutueshme) në anën e gabuar të historisë. Ky libër nuk është sulm i ashpër ndaj Ataturkut; përkundrazi, e demonstroi natyrën e arritjeve të tij. Por, qëllimi i tij kryesor është shpallja se sa e tmerrshme ishte situata politike në Turqi në vitet e pasluftës dhe sa ishte e pamundshme për secilin që të formonte plan të qartë dhe të arsyeshëm se çfarë lloji i shtetit do të bëhej.

Disfata e vitit 1918 çoi jo vetëm te okupimi i Stambollit nga Aleatët (poshtërim i madh), por edhe te pushtimi franko-britanik i territoreve kryesore të Perandorisë Otomane të privoncave arabe. Pak a shumë, kjo ka lënë territorin e cunguar që sot e njohim si Turqi.

Diplomatët perëndimorë, me mendje të zakonshme, kanë mundur të mendojnë se kjo ka zgjidhur shumë probleme, duke krijuar shtet nacional të menaxhueshëm për turqit; por, parimi i 'shteteve nacionale' ka tjetër rezonancë për kurdët dhe në të vërtetë edhe për armenët e mbijetuar.

Përndryshe, kush ishte për t'u llogaritur si 'turk'? Një përgjigje e zakonshme ka qenë: myslimani refugjat, i cili flet turqisht. Që nga mesi i shekullit XIX, një numër tejet i madh i refugjatëve myslimanë kishin shkuar në Turqinë

qendrore. Shumë kishin shkuar nga shkatërrimi gradual i Perandorisë Otomane në Ballkan, por deri në një milionë kishin ikur nga pushtimi rus i Kaukazit. Disa u asimiluan e disa jo; disa u joshën nga retorika e re 'shtetësia otomane' – që kishte të bëjë me parimin e lojalitetit ndaj perandorisë – kurse disa u ngjiten pas pikëpamjes së ngushtë religjioze të sulltanit si kalif i emëruar në mënyrë hyjnore të prijësisë feudale. Por, shumë prej tyre, të përzënë nga atdheu nga forcat e krishtera, e sollën me vete një armiqësi të re ndaj të krishterëve – përfshirë grekët, armenët dhe arabët e krishterë të Turqisë qendrore. Nëse këta të krishterë më herët kishin arsye ta përqafonin identitetin nacional otoman multi-religjioz, shumë shpejt e gjithnjë e më pak patën arsye që të ngjiten për të.

Në këtë kuti llamarine, në maj të vitit 1919, Aleatët hodhën një mjet ndezës: e lejuan armatën greke që ta invadonte dhe okuponte qytetin Smirna (Izmirin). Pasoi një luftë e përgjakshme, pasi që forcat nacionaliste turke – të komanduara nga Ataturku dhe të mohuara nga sulltani – u përgjigjën me luftë. Më 1921 grekët avancuan gati deri në Ankara, në zemër të Turqisë; megjithatë, ende kishte turq që ishin tejet armiqësorë ndaj Ataturkut. Pse?

Për Ali Kemal, poenta kryesore ishte se Aleatët kishin fuqi ndaj

Turqisë dhe se, nga kjo, ishte e nevojshme të punohej me ta (veçanërisht me Britaninë). Ai, po ashtu i denoncoi lidhjet e lëvizjes së Ataturkut me xhonturqit, të cilët e kishin çuar vendin në humbje në Luftën e Parë Botërore dhe kishin masakruar aq shumë të krishterë. Pastaj, kishte minoritete myslimane, siç janë kurdët dhe refugjatët nga Kaukazi, të cilët frikësoheshin se nacionalizmi i ri dhe i ngushtë turk së shpejti do t'i merrte edhe ata në sy. Dhe, kishte myslimanë tradicionalë të shokuar nga eliminimi i sulltanit-kalifit, të cilin Ataturku e kishte bërë si një kukull – tradhtar i Perëndimit. Madje, juristët më eminentë myslimanë otomanë kishin nxjerrë fetfa që e dënonte Ataturkun me vdekje për braktisje nga feja.

Ryan Gingeras e rrëfen këtë tregim me qartësi, aq sa lejon dendësia e zhvillimeve; ai merr qasje të drejtë ndaj kësaj çështje, por duke mos i ndriçuar kurrë vuajtjet e tmerrshme njerëzore që dolën nga secila anë. Turqit për një kohë të gjatë janë trajtuar në mënyrë tejet të thjeshtësuar në historinë bashkëkohore. Ky libër na e mëson fillimin e diturisë, që është se shumica e historisë njerëzore, siç ka ndodhur në të vërtetë, është rrëmujë hutuese e tmerrshme. /Telegrafi/

'The Last Days of the Ottoman Empire' është botuar në Londër nga Allen Lane.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Mbi 30 mijë euro për sportistët e xhudos



Xhudistet Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu, xhudisti Dardan Cena dhe trajneri Driton Kuka janë shpërblyer me 31 500 euro për sukseset e arritura në arenën ndërkombëtare

"Epoka e re"

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Me 31 500 euro janë shpërblyer xhudistet Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu, xhudisti Dardan Cena dhe trajneri Driton Kuka për sukseset e arritura në arenën ndërkombëtare. Ndarja e shpërblimeve është bërë të mërkurën në Qendrën Kombëtare të Xhudos në Pejë. Me 14 mijë euro është shpërblyer xhudistja Distria Krasniqi që fitoi medaljen e bronzitë në

Kampionatin Botëror për seniorë në kategorinë -52 kg. Xhudistja tjetër, Laura Fazliu, është shërbyer me 5 mijë euro. Laura e fitoi medaljen e bronzitë në kategorinë -63 kg në Kampionatin Evropian të Xhudos U23 për seniorë. Një sukses nga sporti i xhudos e arriti edhe xhudisti Dardan Cena për medaljen e bronzitë të fituar në Kampionatin Evropian U21. Për këtë sukses ai është shpërblyer me 2 mijë euro. Për këto tri suksese me 10 500 euro është shpërblyer trajneri Driton Kuka. "Në Qendrën

Nacionale të Xhudos në qytetin e Pejës, aty ku filloi rrugëtimi i sukseseve të panumërta të vendit tonë në xhudo, ndamë shpërblimet shtetërore për rezultatet e fundit të arritura nga xhudistët Distria Krasniqi, Dardan Cena, Laura Fazliu dhe trajneri Driton Kuka. Mbështetje financiare në vlerë totale prej 31 500 eurosh për rezultatet e arritura në garat ndërkombëtare", ka shkruar ministri Çeku në "Facebook". "Po sot Federata e Xhudos së Kosovës ka pranuar çmimin mirënjohës

nga ministri i Punëve të Jashtme i Japonisë, Hayashi Yoshimasa, për kontributin për promovimin e kulturës japoneze në Kosovë dhe bashkëpunimit të mirë në mes të Japonisë dhe Kosovës përmes sportit të xhudos. Këtë mirënjohje, që është një privilegj i veçantë për shtetin tonë, e ndau zëvendësambasadori i Ambasadës së Japonisë në Austri, Jutnichihiro Otaka, në prani të të ngarkuarit me punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë, Keisuke Yamanaka, zëvendësministres së MKRS-së,

Daulina Osmani, presidentit të Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, trajnerit Driton Kuka, kryetarit të Federatës së Xhudos në Kosovë, Agron Kuka dhe xhudistëve. Shpreh falënderim të veçantë për Qeverinë e Japonisë që përmes ambasadave në Kosovë dhe në Austri na bashkohen në festimin e çdo rezultati të xhudistëve tanë dhe për përkrahjen e vazhdueshme për zhvillimin e sportit të xhudos në Kosovë", ka shtuar ministri Çeku.

Hajdari: Jemi gati të luftojmë për vendin tonë



Prishtinë, 2 nëntor - Arlinda Hajdari ishte lënduar verën e kaluar derisa po luante për Kosovën. Arlinda ka pasur fazë të suksesshme rikuperimi dhe tashmë është plotësisht e gatshme. Pas ndeshjeve në Ligën B të Danimarkës, Arlinda është grumbulluar me Përfaqësuesen e Kosovës në hendboll. Ajo ka shfaqur nivel në ndeshjet përgatitore me Greqinë, ndërsa është e gatshme për dy takimet kualifikuese me Ishujt Faroe. Ndeshja e parë me Ishujt Faroe është të enjten nga ora 19:30 në

palestrën e qytetit në Istog. Ndeshja e dytë është, po ashtu, në Istog, të shtunën me fillim nga ora 19:30. Arlinda ka treguar që atmosfera në kombëtare është shumë e mirë. "Përgatitjet po shkojnë mirë. Kemi pasur dy ndeshje miqësore me Greqinë ku kemi provuar taktika të ndryshme, që të jemi gati për ndeshjet me Ishujt Faroe. Atmosfera në ekip është fantastike dhe jemi gati të luftojmë për vendin tonë. Premtojmë maksimumin ndaj Ishujve Faroe", ka thënë Hajdari.

FBK-ja dënon KB Peja

Pejë, 2 nëntor - Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) ka vendosur që ta gjobisë KB Pejën. Për shkak të shkeljes së rregullit për sjellje të tifozëve, lideri i Superligës së Kosovës në basketboll, Peja, është dënuar me 200 euro, sipas nenit 49 të Rregullores së Komisionit të Garave. "Sjellja e shikuesve: 9 sekonda pa përfunduar loja, shikuesit e KB Peja kanë ndezur fishekzjarrë. KB Peja dënohet me 200 euro, konform nenit 49.10 të PG", shkruante në komunikatën e KE-së. Nën drejtimin e trajnerit turk, Can Sevim, Peja është e pamposhtur në Superligën e Kosovës në basketboll, duke e nisur këtë edicion me një bilanc: tetë fitore dhe asnjë humbje.



Vazhdon shkëlqimi i Bad News Eagles

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Bad News Eagles doli fitues në ndeshjen ndaj ekipit GamerLegion në Brazil, ku arriti ta sigurojë fazën "Legends Stage", në turneun më të madh të CS:GO i cili shpërndan çmime në vlerë 1.2 milion dollarë. Ndeshja

ndërmjet dy ekipeve u zhvillua në formatin "Bo3", ku gjithë kohës dominoi ekipi shqiptar duke fituar me rezultat të përgjithshëm 2-0. Paraqitje të mirë treguan të gjithë lojtarët e ekipit shqiptar, më i dalluari ishte Rigon 'rigoN' Gashi, me

vlerësimin nga HLTV 1.53. Pas kësaj fitore Bad News Eagles me tri fitore dhe asnjë humbje ka kaluar në fazën "Legends Stage", së bashku me nëntë ekipe të tjera botërore, dhe gara për ta në këtë fazë do të fillojë më 5 nëntor.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, Programit Komunal trevjeçar për banim 2022-2025 i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.360/01-52753 i datës 28.09.2022, nenit 4 të Udhëzimit nr.23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit, Komuna e Lipjanit shpallë:

KONKURS PUBLIK

Komuna e Lipjanit ka siguruar Program të veçantë të banimit për familjet me gjendje të rëndë sociale dhe ekonomike, që nuk e kanë zgjidhur çështjen e banimit, **duke destinuar për ndarje 10 banesa** të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit, me qira joprofitabile për të krijuar kushte të përshtatshme për banim normal.

- Të drejtë të jenë përfitues të këtij programi janë familjet që:

1. Nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
2. Kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë;
3. Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike.

- Përcaktimi i personave /familjeve përfituese bëhet mbi bazën e kritereve të përparësisë, si vijon:

1. Statusi i banimit;
2. Lartësia e të ardhurave ;
3. Gjendja shëndetësore;
4. Invaliditeti i pjesëtarve të familjes dhe
5. Struktura familjare

- Kriteret shtesë janë:

1. Familje dëshmori
2. Familje e kryesuar nga njëri prind/prindi vetëshqyes dhe
3. Familja që kanë mbikqyrje / përkujdesje fëmijët jetimë.

Familjet që bëjnë kërkesë për të përfituar nga ky program i banimit, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe banorë të përhershëm të Komunës së Lipjanit.

- Për zgjedhjen e përfituesve nga programi i veçantë i banimit, përparësi kanë familjet me numrin më të madh të pikëve, sipas tabelës së vlerësimit të përcaktuar në shtojcën 1 të

“Udhëzimit administrativ nr.21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit”.

-Në rast se aplikuesit pas vlerësimit arrijnë numër të njëjtë të pikëve, atëherë përparësi do të kenë familjet me shumë anëtarë sipas nenit 5 paragrafi 4 të Udhëzimit administrativ nr.21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.

- Komuna si investitor, ka në dispozicion për këtë program të veçantë të banimit banesat në pronësi të Komunës të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit në kuadër të objekteve të ndërtuara paraprakisht me koncesion në rrugët “Isa Olluri” dhe “Lidhja e Prizrenit”, të cilat i jep me qira joprofitabile për kategoritë me gjendje të rëndë sociale ekonomike dhe të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

-Aplikacionen merren dhe dorëzohen në Qendrën për Shërbime me qytetarë kati i parë – sporteli nr. 1 dhe 2 çdo ditë pune. Konkursi mbetet i hapur 30 (tridhjetë) ditë nga dita e shpalljes publike në njërin nga gazetat e përditshme dhe në faqen elektronike të Komunës, ndërsa raporti dhe dokumentacioni i kompletuar i përcillet komisionit vlerësues brenda 5 ditësh.

-Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e familjeve bën shqyrtimin e gjendjes së banimit dhe të dhënave tjera të nevojshme të aplikuesve, si dhe vlerësimin dhe verifikimin në teren të parashtruesit të kërkesës brenda afatit prej 30 ditësh.

-Aplikacionet e dorëzuara pas afatit kohor, të pakompletuara dhe të paplotësuara me të dhënat e nevojshme , nuk do të pranohen dhe do të konsiderohen të pavlefshme.

- Kur aplikuesi me vetëdije jep deklaratë të rrejshme apo paraqet dokumentacion të falsifikuar, humb të drejtën për t'u kualifikuar si shfrytëzues i këtij programi social.

- Ndalohet bërja publike e të dhënave mbi procesin e përzgjedhjes para publikimit të listës së familjeve të përzgjedhura.

- Komuna në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve do të publikojë listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fituara dhe kundër Vendimit të Komisionit Vlerësues, pala e pakënaqur mund të parashtrorë ankesë me shkrim brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit . Ankesa i parashtrorët Ministrisë së Mjedisit ,Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës MMPHI.

INr. 360/01-59084
Lipjan, më 02.11.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovi Zakona Br.03/L-164 Za financiranje posebnih programna za Stanovanje, Opštinskog Trogodišnjeg Programa za Stanovanje 2022 -2025 usvojen na osnovi Odluke Skupštine Opštine 15Br.360/01-52753 dt 28.09.2022, člana 4 upustva br.23/2010 za procedure za objavljivanje posebnih programa za stanovanje, Opština Lipljan objavljuje :

JAVNI KONKURS

Opština Lipljan je obezbedila posebni program za stanovanje za porodice u teškom ekonomskom i socialnom stanju koji nemaju rešeno problem stanovanja, destinirajući za podelu 10 stana koje se nalaze u gradu Lipljan sa neprofitabilnoj kirijom da bi obezbedilo normalne uslove za stanovanje.

- Pravo da budu dobitnici od ovog programa su porodice :
 1. Nemaju stan ili kuću u individualnom posedu
 2. Ostali bez stana/kuću kao posledica oštećenja kuća tokom poslednjeg rata na Kosovu.
 3. Uvlasništvo su stambenog prostora ispod određenih norma za tu socialnu ekonomsku kategoriju.

- Određivanje individa/porodica dobitnika se obavlja na osnovi kriterijuma I sledećim prednostima:

1. Status Stanovanja
2. Visina prihoda:
3. Zdravstveno stanje:
4. Invalidnost članova porodice i
5. Porodična struktura

Dodatne kriterijumi su:

1. Porodice vođene sa jednim roditeljom/ roditelj samohranitelj porodice
2. Porodice koje imaju podnadgledanju / decu siročad

Porodice koje podnose zahtev za dobijanje iz ovog programa za stanovanje treba da budu državljani Republike Kosova i stalni stanovnici Opštine Lipljan.

- Za izbor dobitnika programa za stanovanje prednost imaju porodice sa većim brojem bodova, prema tabeli za procenjivanje određene sa dopisom br 1 „Administrativnom Upustvo br.21/2010 za određivanje reda prednosti za kategorije porodica koje mogu da dobiju iz programa za stanovanje,, .

- U slučaju da aplikant nakon procenjivanja dostiže isti broj bodova, tada prednost će imati porodica sa većim brojem članova prema članu 5 stav 4 „Administrativnom Upustvo br.21/2010 za određivanje reda prednosti za kategorije porodica koje mogu da dobiju iz programa za stanovanje,, .

- Opština kao investitor ima u dispoziciju za vaj posebni program stanovanja stanove u vlasništvo Opštine koje se nalaze u gradu Lipljan u okviru objekata dati sa konsesijom u ulice „Isa Olluri,, i „Lidhja e Prizrenit,, koje se daju sa neprofitabilnom kirijom za kategoriju u teškom ekonomskom stanju i koje nemaju rešeno stambeni problem.

- Aplikacije se uzimaju i se dostavljaju u Centru za Usluge za građanena prvom spratu br.1i 2 svakog radnog dana.konkurs ostaje otvoren 30 dana od dana javnog objavljivanja u nekoj dnevnoj Novini i u leketronskom web sajtu opštine, dok izveštaj i dokumentacija kompletirana se dostavlja Komisiji za procenjivanje u roku od 5 dana

- Komisija za Procenjivanje za izbor porodica obavlja pregled stanja stanovanja i drugih podataka aplikanta, kao i procenjivanje i verifikaciju na terenu podnosioca zahteva u roku od 30 dana.


- Aplikacije dostavljene nakon vremenskog roka ne kompletirane i ne popunjene sa potrebnim podacima neće se primati i ne će se smatrati važeće.

- Kada aplikant pod svestom daje lažne deklaracije ili dostavlja falsifikovane dokumentaciju gubi pravo da bi se klasifikovao kao dobitnik socialnog programa. Zabranjuje se objavljivanje podataka o procesu izabranja pre objavljivanja liste izabranih porodica.

- Opština na službenom sajtu Opštine i u tabeli za oglase će da objavljuje listu porodica rangirane prema dobijenim bodovima. Odluci Komisije za procenjivanje nezadovoljna stranka može da podnesi pismenu žalbu u roku od 30 dana od dana prijema Odluke žalbu dostavljati u Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja infrastructure MSPPI.

1Br. 360/01-59084
Lipjan 02.11.2022





Kompania Regjionale për Mbeturina
„AMBIENTI” Sh.A. Xhem Sadria Pn. Pejë

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
„Ambienti” SH.A. PEJË
Nr. 1605
Data: 02.11.22

KRM AMBIENTI SHA PUBLIKON KËTË :

ANULIM TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave SHA Pejë ,anulohet konkursin e shpallur ne gazeten Epoka e Re te dates 06.09.2022 per vendin e punës Punëtor Fizik
Anulohet konkursi ne baze te vendimit te komisionit te dates 02.11.2022 me numer protokoli 1604

Pejë

Datë 02.11.2022



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
„Ambienti” SH.A. PEJË
Nr. 1615
Data: 02.11.2022

KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA “AMBIENTI”- SH.A. PEJË

-NJËSIA OPERATIVE NË ISTOGË

Bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit me Nr. 03/L-212 Të punes, dhe neni 3 te paragrafi 1 udhëzimit administrative Nr. 07/2017 Per themelimin e mardhënjes së punës në Sektorin publik

Publikonë këtë konkurs :

Pozita: Inkasant

Ekzekutues : 1 (një)

Kohzgjatja e kontratës : të pacaktuar

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

1. Bënë inkasimit nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe ngarkohet materialisht me fatura sipas rrugëve dhe reoneve
2. Për çdo ditë dorëzon pazarin ditor dhe ngarkohet me fatura.
3. Plotëson fletë dorëzimin mbi kryerjen e pagesave me shënimet e duhura.
4. Përcjell gjendjen në teren për zbulimin e sipërfaqeve në sektorin private dhe
5. Bënë evidencën e tyre dhe me shkrim e informon shefin e shërbimit.
6. Është i obliguar që të përcjellë ndërrimin e pronarit të banesave, shtëpive dhe të merr shënimet të cilat i dorëzon shërbimit komercialo-financiar.
7. Është i obliguar që për çdo parregullsi në fatura, t'i kthejë në rilogaritje.
8. Obligohet që në teren të silltet korrekt dhe të mban uniform apo shenjë identifikimi të Ndërmarrjes.
9. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Shefit të inkasantëve, Përgjegjësit Financiar dhe Kryeshefit Ekzekutiv
10. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

Kushtet:

-Shkolla e mesme ekonomike

-Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion.

- Çertifikaten që kandidati nuk është nën hetime

-1 vite përvojë pune ,në punë të ngjajshme

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë,nga dita e publikimit , aplikacionet merren pranë zyreve në Pejë dhe dokumentet dorëzohen ne zyret qendrore në Pejë,te gjitha te fotokpjuara ,dokumentet e pa kompletuara dhe të dorzuara pasë afatit nuk do të pranohen.



Kompania Regjionale për Mbeturina
„AMBIENTI” Sh.A. Xhem Sadria Pn. Pejë

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
„Ambienti” SH.A. PEJË
Nr. 1607
Data: 02.11.22

KRM AMBIENTI SHA PUBLIKON KËTË :

ANULIM TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave SHA Pejë, për Njesin Operative Istogë ,anulohet konkursin e shpallur ne gazeten Epoka e Re te dates 05.09.2022 per vendin e punës Punëtor Fizik dhe Arkatar/e
Anulohet konkursi ne baze te vendimit te komisionit te dates 02.11.2022 me numer protokoli 1606

Pejë

Datë 02.11.2022



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
„Ambienti” SH.A. PEJË
Nr. 1616
Data: 02.11.22

KONKURS PUBLIK

KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA “AMBIENTI”- SH.A. PEJË

-NJËSIA OPERATIVE NË PEJË

Bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit me Nr. 03/L-212 Të punes, dhe neni 3 te paragrafi 1 udhëzimit administrative Nr. 07/2017 Për themelimin e mardhënjes së punës në , sektorin publik

Pozita : 5 / pesë / PUNËTOR FIZIKË- / NË MBLEDHJEN E HEDHURINAVE


Detyrat dhe përgjegjësit :

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
 2. Mbledh hedhurinat dhe bëjnë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
 3. Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
 4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
 5. Kryen edhe punë tjera me urdhëres Shoferit, Kryepunëtorit
 6. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejt Shoferit, Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kryeshefit Ekzekutiv
- Konkursi i shpallur ,është për afat gjashtë mujorë me mundësi vazhdimi



Kushtet:

- Shkollimi fillorë
- Aftesi fizike dhe psikike te deshmuar
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë,nga dita e publikimit , aplikacionet merren në zyret e qendrore ,dokumentet dorëzohen ne zyret qendrore Pejë ,te gjitha te fotokpjuara .



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës - Municipality of Prishtina

SHKOLLA FILLORE dhe e MESME E ULËT "PAVARËSIA" PRISHTINË
Nr. Prot. 03/ 836 Dt.02.11.2022

KERKESË PËR OFERTË

Këshilli Drejtues i Shkollës "Pavarësia" fton të gjitha kompanitë e interesuara, të konkurojnë në kërkesën tonë për uniforma të nxënësve.

Kërkojmë:


- *Një *DUKS*(pa kapelë) dhe një *MAICË*(me mëngë të shkurtëra)
- *Materiali të jetë i cilësisë së lartë
- *Modelet e ofruara të jenë konformë me nivelin e moshës së nxënësve dhe të përshtatura me kodin e veshjes për nxënës.
- *Çmimi të jetë i pranueshëm me standarin aktual të tregut.

Konkuresit duhet ta kompletojnë dokumentacionin, si në vijim:

- Çertifikatën e biznesit
- Çertifikatën e regjistrimit
- Vërtetimin tatimor(me numër fiskal)
- Kopjen e letërnjoftimit
- Kopjen e kartelës bankare(xhirollogaria)
- Lejën e punës dhe referenca

Kujdes!
Ofertat duhet të sillen në zarf të mbyllur nga data 03.11.2022 deri me 11.11.2022, në zyrën e sekretarit të shkollës brenda afatit, nga ora 11 deri në 12.
Të gjithë procesin, do ta udhëheq Komisioni i zgjedhur nga KDSH i shkollës.

Për Komisionin





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Altun Mazreku shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Abdyl Frashëri" Prizren.

- Yll Jerliu shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. VI-IX të shkollës "7 Marsi" Prishtinë.

- Gjemajli Shala shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "17 Shkurti" Hatmaxhe.

- Arber Kabashi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.

- Martin Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Dy Dëshmorët" Pirane.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
 [Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales